



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit

Nr.07-Zyrtarisht

19.12.2022

Në bazë nenit 67, 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Deçanit, shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Institucioni: Komuna e Deçan

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës:

- 1.Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU "Isa Boletini" në Isniq
 - Numri i Pozitave: (2)
 - Orët e punës: 40 orë në javë
 - Paga bazë: 397.01 Euro
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 2.Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU "Lan Selimi" në Lumbardh
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Orët e punës: 40 orë në javë
 - Paga bazë: 397.01 Euro
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 3.Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Deçan
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Orët e punës: 40 orë në javë
 - Paga bazë: 397.01 Euro
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 4.Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU "Rexhep Kadrijaj" në Rastovicë
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Orët e punës: 40 orë në javë
 - Paga bazë: 397.01 Euro
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).

Lloji i Pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik;
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Institucionit;

Punët detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore:

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, pozitën dhe uljen e nxënësve në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folurit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevoja fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etiken e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton plotësisht konfidenciale.

Kriteret e kualifikimit për Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore:

1. Niveli i 5-të (post-sekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës me nevoja të veçanta arsimore

Vërejtje: Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 8 paragrafi 6, pika 6.1, "Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin e 5-të (post sekondar) të kualifikimit për asistent, për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore "i plotësojnë kriteret për punësim".

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit;
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta – kopje- shtetësi Kosovare) -
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;

- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Afati dhe mënyra e publikimit: Konkursi mbetet i hapur (15 ditë) në faqen zyrtare të Komunës, tabelën e shpalljeve, aplikacionet dorëzohen nga data 19.12.2022 deri me 06.01.2023 (16:00)

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet duhet ti shkarkojnë nga portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe faqen zyrtare të komunës, dhe të plotësojnë ti dorëzojnë në Drejtorin për Arsim, (Zyrën nr. 52). Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen DKA-së, zyra nr.52 Kati-III.

Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/>

